

VENDIM
Nr. 72, datë 3.2.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSIONI DHE
ASFALTIMI I RRUGËVE TË LAGJEVE NË
KODËR-VORË, LOTI 1”, BASHKIA VORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugëve të lagjeve në Kodër-Vorë, loti 1”, Bashkia Vorë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vorë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “tokë truall”, me sipërfaqe 276 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m², dhe për pasurinë “objekt”, me sipërfaqe 42 (dyzet e dy) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 2 025 498 (dy milionë e njëzet e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh.
 4. Vlera epërgjithshme e shpronësimit, prej 2 025 498 (dy milionë e njëzet e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vorë, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Vorë.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Vorë të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 8. Regjistrimi i ri i pasurive “tokë truall”, me sipërfaqe 276 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m², dhe “objekt”, me sipërfaqe 42 (dyzet e dy) m² për realizimin e projektit “Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugëve të lagjeve në Kodër-Vorë, loti 1” të bëhet në favor të Bashkisë Vorë.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vorë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SHPRONËSIMIT, QË DO TË PËRDORET PËR “RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I RRUGËVE TË LAGJEVE NË KODËR-VORË, LOTI 1”, BASHKIA VORË

Nr.	Emri mbiemri	Nr. i pasurisë	ZK	Lloji i pasurisë		Vlera e truallit/lekë	Vlera e ndërtesës/lekë	Vlera e shpronësimit në lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
				Truall/m ²	Objekt /m ²				
1	Bashkëpronarët Maloku:Haxhire Maloku Inndrit Maloku Alfonc Maloku Adrian Maloku Elvir Maloku (Deliallisi)	586/6/1	2183	228	42	559,056.00	1,348,746.00	1,907,802.00	Konfirmim nga ZVRPP-ja
2	Ismail Karreci	467/10	2183	24		58,848.00		58,848.00	Konfirmim nga ZVRPP-ja
3	Kalosh Gjeta	100/8/1	2183	24		58,848.00		58,848.00	Konfirmim nga ZVRPP-ja
	TOTALI							2,025,498.00	

